



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Çështjes: 52104-01035-11-2009

Data e Regjistrimit: 14/12/2009

Numri i Vendimit 11-2011-625

Data e Vendimit: 09/02/2011

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

KRYESUES: Neritan Tabaku

ANËTAR: Fejzo Hysi
Ndue Gjura

SEKRETARE: Neritan Tabaku

Sot më datë: 09/02/2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket

Të pandehurit: Ilir Xhakja, i biri i Azem dhe i Lumturie, i datëlindjes 05/11/1974, banues në Durrës

Akuzuar: "Vrasjes me paramendim" kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit"

Gjykata pasi shqyrtoi materialet e fashikullit gjyqësor, provat e marrura gjatë gjykimit dhe pasi dëgjoi palët ;

Prokurorin i cili në përfundim të gjykimit kërkoi :

1. Të deklarohet fajtor i pandehuri Ilir Xhakja për veprën penale të vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/I e 25 të K.Penal e dënimin e tij me 24 (njëzetekatër) vjet burgim.

2. Pushimin e çështjes penale për sa i përket akuzës së mbajtjes pa leje të armëve luftarake e municioneve të parashikuar nga neni 278/II i K.Penal, si dhe ngarkimin e të padnehurit me shpenzimet proceduriale në hetime paraprake

Mbrojtësin e të pandehurit, Av.A. Shala i cili në përfundim të gjykimit kërkoi pafajsi për klientin e tij, pasi nuk provohej që ai të ketë kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet,

VEREN

I pandehuri Ilir Xhakja duhet të deklarohet i pafajshëm për akuzën e veprës penale të vrasjes me paramendim të shtetasit Qerim Maloku, të kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 78 paragrafi I e 25 të K.Penal, pasi nuk provohet që i pandehuri ta ketë kryer veprën penale që

akuzohet, ndërsa në lidhje me akuzën e mbajtjes pa leje të armëve e municioneve luftarake parashikuar nga neni 278/II i K.Penal, gjykata bazuar kjo në nenin 387/I të K.Pr.Penale çmon se duhet pushuar çështja penale.

Në gjykimin e kësaj çështje penale rezultuan këto rrethana fakti.

Më datë 26.07.1998, rreth orës 23:00, në vendin e quajtur Katund Sukth, është vrarë me armë zjarri shtetasi Qerim Maloku banor i fshatit Sukth.

Para se të vritej, viktimi Qerim Maloku kishte dalë nga banesa e tij, kishte shkuar tek lokali nipit tij e kishte pirë diçka aty dhe më pas ishte nisur për tek një bilardo që ndodhej pranë banesës tij. Gjatë rrugës për tek bilardo viktimë është goditur me breshëri automatiku nga persona të pa identifikuar.

Me dëgjimin e krismave, menjëherë ishin afruar nipi tij Agron Maloku dhe persona të tjerë e më pas kishte shkuar dhe djali tij Ylli Maloku.

Në vend ngjarje kanë shkuar forcat e policisë së bashku me oficerët e policisë gjyqësore të cilët kanë nisur nga puna për mbledhjen dhe marrjen e provave materiale dhe atyre më dëshmitarë.

Më pas Prokuroria Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi bazën e materialeve të grumbulluara ka filluar procedimin penal Nr.352 për veprat penale të parashikuara nga nenet 78, 25 e 278/2 të K.Penal.

Në hetimet paraprake janë pyetur dëshmitarët Agron Maloku, Selami Sheta, Florian Metalla, Shkëlqim Sheta, Gëzim Laska e Besnike Maloku si dhe janë kryer disa veprime procedurale si ;

1. Është bërë kqyrja e vendit ngjarjes,

2. Është fotografuar vendi ngjarjes (14 copë),

3. Është bërë skica e vendit ngjarjes,

4. Është kryer akti ekspertimit mjeko ligjor Nr.53 datë 27.07.1998 ku është arritur në konkluzionin se ; *“Në trupin e kufomës Qerim Maloku u vërejtën plagë tejshkuese në kraharror, dëmtim i rëndë i zemrës, mushkërisë etj, dëmtime këto të cilat ishin shkaktuar nga armë zjarri, drejtimi qitjes ishte nga para – prapa, distnaca e qitjes ishte e largët mbi 1.5 m dhe se shkaku i vdekjes së Qerim Malokut ishte dëmtimi i rëndë i zemrës, mushkërisë, kockave të kafkës dhe trurit nga predhat e armës së zjarrit që kanë sjellë për rjedhojë shokun e rëndë traumatiko-hemoragjik.”*

4. Është bërë Akti ekspertimit balistik gëzhgojash Nr.168 datë 31.07.1998 nga eksperti Shkëlqim Xhemollari ku është arritur në konkluzionin se ; *“1. Gëzhgojat objekt ekspertimi të fiskuara si prova materiale në ngjarjen e datës 26.07.1998 në Katund i Ri Sukth ku është me vrarë me armë zjarri shtetasi Qerim Maloku u përkasin fishekëve standarte luftarak të modelit 56, kalibër 7,62 mm, të cilët përdoren si municion bazë për pushkë, automatikët dhe mitralozët e lehtë të po këtij kalibri. Tetë gëzhgojat objekt ekspertimi janë qitur nga dy armë zjarri, dy nga një armë dhe gjashtë nga një armë tjetër. 2. Gjashtëdhjet fishekët objekt ekspertimi janë të mod.56, kal. 7,62 mm e ata janë në gjëndje të rregullt teknike.”*

5. Akti ekspertimit vlerësues i provave materiale Nr.891 datë 03.08.1998 i kryer nga ekspertët Atlie Bogdani, Flora Shehu e Orest Afezolli që ka arritur në konkluzionin se ; *“Mbi sipërfaqet e jashtme të karikatorëve objekt ekspertimi, nuk u evidentua ndonjë gjurmë gishti e vlefshme për identifikim.”* etj.,

Nga hetimet rreth kësaj çështje, sipas organit të akuzës rezulton se kane qenë dy autorë të vrasjes, por meqë nuk është bërë e mundur identifikimi dhe zbulimi i këtyre autorëve dhe në kushtet që janë kryer veprimet e nevojshme hetimore, me vendimin e datës 12.10.1998, është bërë pezullimi i hetimeve për procedimin penal Nr.352.

Më datë 18.03.2002, pra rreth katër vjet më vonë, rreth orës 10:00, në vendin e quajtur Kodra e Vreshtit të Jubës, nga ana e policisë së rendit janë gjetur dhe sekuestruar një sasi armësh, si automatikë kallashnikov, revolver, karikatorë etj,

Me anë të procesverbalit “Mbi kqyrjen e vendit” të mbajtur nga Oficeri Policisë Gjyqësore Reshat Kalaci më datë 18.03.2002 theksohet se në një tunel në Kodrat e Jubës, në Sukth janë gjetur dhe

fiksuar me cilësinë e provës materiale ;

1.Një automatik kallashnikov, prodhim kinez, numër 14236682, pa bajonetë, pa rrip dhe pa qytë, me fishek në gojë, me dy krëhëra të bashkuar me natrian, me ngjyrë të zezë, të mbushur me fishekë gjurmëlënës.

2.Një automatik kallashnikov, prodhim kinez, me numër 14232935, pa bajonetë, pa qytë e pa rrip, me fishek në gojë, me dy krëhëra të bashkuar me natrian me ngjyrë bezhë, mbushur me fishek nga ato shenjëlënës,

3.Një automatik tip Zastava, pa rrip, me qytë metalike të përthyeshme, me dorezë të zezë, me numër 509465, prodhim i vitit 88, i mbështjellë me një peshqir të bardhë dhe një copë basme lulesh.

4.Mbështjellë me këtë automatik gjëndet një pistoletë tip revolver me mulli, me pesë fishekë bredna në mulli, me numër 404468, me dorezë të mbështjellë me dy pafte briri me ngjyrë bezhë.

5.Një krëhër pistolette me numër 2345, me katër fishekë model 54,

6.Dy krëhëra automtiku të bashkuar me natrian me ngjyrë kafe, të mbushur me fishekë gjurmlënës.

7.Tre kuti kartoni me fisihekë model 54, ku dy janë të pahapura me nga 70 copë secila dhe njëra është e hapur me 50 copë fisihekë (pra gjithsej janë 190 copë fishekë).

8.16 krëhëra të vegjël (pushkë dhejtëshe), me fisihek model 56, me 15 copë fishekë gjithsej. Si dhe disa objekte te tjera të futura në një çantë me doreza pajisje ndërlidhje si dhe karikuesa baterish, tre aparate baza karikimi, tre radio marrëse, një mikrofon dore etj.,.

Në lidhje me armët e sekuestruara në Kodër Jubë janë kryer disa akte ekspertimit konkretisht ;

1.Akti i ekspertimit vlerësues i provës materiale Nr.641 datë 19.03.2002 nga ekspertët Atlie Ylli, Ilirjan Avrami, Arjan Hako, Ferit Lamaj, me konkluzionin se : *“vetëm mbi sipërfaqen e njërit prej fishkëve shenjëlënës model 56, kalibër 7.62 mm, që ndodhej brenda dy krehërave të bashkuar me ngjitës natrian me ngjyrë bezhë, fiksuar në ngjarjen e ndodhur më datë 18.03.2002, u përftua një gjurmë papilare gishti e emërtuar “A” e vlefshme për identifikim”*. Në pikën 2 të konkluzionit saktësoshet se në tërësinë e objekteve të tjerë nuk u fiksuan gjurmë papilare të vlefshme për identifikim.

2.Akti Nr.644 datë 19.03.2002 “Ekspertim daktiloskopik” datë 19.03.2002 bërë nga ekspertët Ardian Shehu e Orest Afezolli, ka nxjerrë konkluzionin se ; *“gjurma e gishtit objekt ekspertimi shënuar me shkronjën “A” e fiksuar mbi sipërfaqen e një fisheku, bllokuar si provë materiale në Kodrën e Vreshtit Jubë Durrës, më datën 18.03.2002, është formuar nga gishti i madh i dorës së djathtë të shtetasit Ilir Azem Xhakja.”*

3.Akt Nr.686 datë 21.03.2002 “Ekspertim teknik arme e balistik gëzhgojash” bërë nga ekspertët Nikolin Duraj e Shpëtim Huda që ka arritur në konkluzionin se *“Tre automatikët objekt ekspertimi model 56, kalibër 7,62 mm, me numra 14232935, 14236682 dhe 509465, në gjëndjen që paraqiten janë të rregullt teknikisht dhe të përshtatshëm për qitje, gëzhoja objekt ekspertimi e fiskuar në ngjarjen e datës 16.03.2002, vrasje me armë zjarri e shtetasit Rudin Shahini, nuk është qitur nga automatikët objekt ekspertimi model 56, kalibër 7,62 mm, me numra 14232935, 14236682 dhe 509465.”*

4.Akt Nr.1633 datë 12.06.2002 “Eksperim balistik gëzhgojash” bërë nga ekspertët Nikolin Duraj e Shpëtim Huda ka arritur në konkluzionin se ; *“Një nga tetë gëzhojat e fiksuar në ngjarjen e datës 26.07.1998, vrasje me armë zjarri e shtetast Qerim Maloku është qitur nga automatiku objekt ekspertimi me nr.14232935”*.

5.Akt Riekspertimi Nr.2853 datë 07.10.2002 bërë nga eksperti Ajdin Mborja dhe përsëri ekspertët, Nikolin Duraj e Shpëtim Huda është arritur në konkluzionin se ; *“Tre gëzhojat objekt riekspertimi të fiksuar në ngjarjen e datës 26.07.1998, vrasje me armë zjarri e shtetasit Qerim Maloku, janë qitur nga tre armë zjarri që duhet të jenë automatike model 56, kalibër 7,62 mm, e përkatësisht gjashtë copë me stampim shifrash “71-64” nga një armë, një copë me stampim shifrash “61-64” nga një armë dhe një tjetër me stampim shifrash “61-64” nga një armë tjetër.*

Nga tetë copë gëzhojat e fiksuar në ngjarjen e datës 26.07.2008, vrasje me armë zjarri e shtetasit Qerim Maloku, një prej tyre është qitur nga automatiku objekt ekspertimi model 56, kalibër 7,62 mm, me nr.14232935”.

Nisur nga sa sipër, duke marrë shkas nga akti ekspertimit Nr.644 datë 19.03.2002, Prokuroria Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e datës 16.09.2002 ka rifilluar hetimet për shtetasin Ilir Xhakja në kuadër të procedimit penal të pezulluar Nr.352 të vitit 1988 duke e marrë si të pandehur Ilir Xhaken për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/1 e 25 dhe 278/2 të K.Penal për vrasjen e shtetasit Qerim Maloku.

Pas organizimit të ri gjyqsor, për faktin që vepra penale e parashikuar nga neni 78 i asokohe ishte në kompetencë lëndore të Prokurorisë Për Krime të Rënda, kjo çështje i ka kaluar kësaj prokurorie e cila ka bërë edhe përfundimin e hetimeve dhe e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Gjykata e Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë me vendimin Nr.15 datë 27.03.2006 ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin Ilir Xhakaj për veprën penale të “Vrasjes me paramendim” dhe në bazë të nenit 78/1 e 25 të K.Penal e ka dënuar atë me 21 vjet burgim dhe ka pushuar çështjen për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake “ parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal.

Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda Tirane me vendimin Nr.46 datë 19.06.2006 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatsë Së Shkallës Parë për Krime të Rënda.

Nga ankimi i të pandehurit, Gjykata e Lartë Tiranë me vendimin Nr.493 datë 14.10.2009 ka vendosur prishjen e vendimit nr.46 datë 19.06.2006 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe vendimin nr.15 datë 27.03.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe ia ka dërguar aktet për gjykim Gjykatës së Shkallës Parë Durrës.

Në rigjykim nga gjykata u morën provat e kërkuara nga organi akuzës si dhe nga avokati mbrojtës i të pandehurit si ato me dëshmitarë dhe provat shkresore.

Duke analizuar në tërësinë e tyre provat e administruara në gjykim, gjykata nuk krijon bindjen që me këto prova lidhet kryerja e veprës penale nga i pandehuri si dhe fajësia e tij, për disa arsye të cilat do ti analizojme dhe më poshtë.

Në vendngjarjen e vrasjes së shtetasit Qerim Maloku, nga ana e grupit hetimor janë gjendur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale veç të tjerash edhe 8 gëzhoja nga të cilat 6 copë me makroforkë “71 – 64” dhe 2 copë me makroforkë “61 – 64”.

Në konkluzionet e dhëna me aktin e ekspertimit balistik Nr.168 datë 31.07.1998, nga ana e ekspertit kriminalist Shkëlqim Xhemollari, në pikën 1 të konkluzioneve është evidentuar se ; “ *Tetë gëzhojat objekt ekspertimi janë qitur nga dy armë zjarri, dy nga një armë dhe gjashtë nga një armë tjetër.*”, ndërkohe që konkluzioni i këtij ekspertimi bie ndesh me konkluzionin e ekspertimit tjetër të nxjerrë me Aktin Nr.1633 datë 12.06.2002 “Eksperim balistik gëzhojash” në të cilin thuhet se ; “ *Një nga tetë gëzhojat e fiksuar në ngjarjen e datës 26.07.1998, vrasje me armë zjarri e shtetasit Qerim Maloku është qitur nga automatiku objekt ekspertimi me nr.14232935*” si dhe me konkluzionin e ekspertimit Aktit të Riekspertimi Nr.2853 datë 07.10.2002 në të cilin thuhet ; “ *Tetë gëzhojat objekt riekspertimi të fiksuar në ngjarjen e datës 26.07.1998, vrasje me armë zjarri e shtetasit Qerim Maloku, janë qitur nga tre armë zjarri që duhet të jenë automatike model 56, kalibër 7,62 mm, e përkatësisht ; gjashtë copë me stampim shifrash “71-64” nga një armë, një copë me stampim shifrash “61-64” nga një armë dhe një tjetër me stampim shifrash “61-64” nga një armë tjetër.* *Nga tetë copë gëzhojat e fiksuar në ngjarjen e datës 26.07.2008, vrasje me armë zjarri e shtetasit Qerim Maloku, një prej tyre është qitur nga automatiku objekt ekspertimi model 56, kalibër 7,62 mm, me nr.14232935”.*

Duke qenë se organi akuzës për të pandehurin Ilir Xhakaj mbështetet tërësisht në konkluzionet e akteve të ekspertimit të cilat janë shkencore dhe kur në rastin konkret aktet e ekspertimit nuk përputhen midis tyre, lënë hapësirë dhe dyshime që nuk e bindin gjykatën për fajësi.

Kështu në aktin e bërë në vitin 1998 kohë në të cilën ka ndodhur ngjarja eksperti thotë se janë tetë

gëzhoja objekt ekspertimi të cilat janë qitur nga dy armë, ndërkohë që ekspertët e mëvonshëm pas katër vjetëve (ato të vitit 2002) në ekspertimin e po këtyre tetë gëzhojave të gjendura në vendin e ngjarjes të datës 26.07.1998, theksojnë se është qëlluar me tre armë dhe një nga këto armë rezulton sipas ekspertëve arma e gjetur në një tunel në Kodrat e Jubës, në Sukth.

Pra rezulton se ruhet sasia e gëzhojave të vendit të ngjarjes të datës 26.07.1998 por cuditërisht shtohen armët duke rënë ndesh me konkluzionin e ekspertimit të kryer në kohën dhe vendin e ngjarjes i cili thekson se është qëlluar me dy armë.

Pikërisht shtohet një armë, që është automatiku me nr.14232935 për të bërë lidhjen midis armëve të përdorura në vend ngjarjen e datës 26.07.1998 dhe atë të ngjarjes të datës 18.03.2002, në një kohë që janë dy ngjarje të shkëputar në kohë dhe në hapësirë dhe që nu lidhen me njëra tjetrën. Nga Akti Nr.644 datë 19.03.2002 "Ekspertim daktiloskopik" datë 19.03.2002 rezulton se ; *"gjurma e gishtit objekt ekspertimi shënuar me shkronjën "A" e fiksuar mbi sipërfaqen e një fisheku, bllokuar si provë materiale në Kodrën e Vreshtit Jubë Durrës, më datën 18.03.2002, është formuar nga gishti i madh i dorës së djathtë të shtetasit Ilir Azem Xhakja."*

Sipas përmbajtjes së këtij akti organi akuzës mbështet akuzën ndaj të pandehurit.

Në shqyrtimin gjyqësor u provua se në asnjë prej akteve të realizuara në kohën që ka ndodhur ngjarja e datës 26.07.1998 ku është vrarë shtetasi Qerim Maloku, nuk vërtëtohet prania apo fiksimi i ndonjë gjurme, provë materiale, që implikojnë të pandehurin Ilir Xhakja në vëndngjarje.

Sikurse provohet në asnjë prej gezhojave të qitura ne vëndngjarjen e dates 26.07.1998 nuk është gjetur asnje gjurme gishti e të pandehurit Ilir Xhakja.

Gjithashtu ka rezultuar e provuar se në asnjë prej fishekëve të ndodhur në dy karikatoret e gjetura në vëndngjarjen e vrasjes te shtetasit Qerim Maloku të datës 26.07.1988 në Katund Sukth si dhe në vetë këto karikatore, nuk është gjetur asnje gjurme gishti e të pandehurit Ilir Xhakja.

Në këtë kontekst teorikisht dhe praktikisht, mundësia për gjurmë gishtash të autorit është pikërisht tek gëzhojat e gjetura në ngjarjen e datës 26.07.1998 ku është vrarë shtetasi Qerim Maloku.

Duke u kthyer tek konstatimi dhe përftimi i kësaj gjurme, sipas organit akuzës nuk shpjegohet rrethanat sesi i pandehuri Ilir Xhakja paska vendosur fishekun në karikatorë dhe nuk konstatohet asnjë gjurmë e gishtit të tij, as në fishekët e tjerë, por është fiksuar vetëm në fishekun e tretë të karikatorit të ngajrjes të datës 18.03.2002, në një kohë që gjurmë gishtash nuk ka as në fishekët e tjerë të gjetura, as në karikatorë, as në natriban që mbështjell dy karikatore, as në automatikun me nr.14232935 ku u gjetën këto karikatore dhe që ka nxjerrë një nga gezhojat e gjetura në vëndngjarjen e vrasjes se shtetasit Qerim Maloku.

Në këto rrethane gjurma e gishtit e përftuar lë dyshime përderisa nuk është fiksuar dhe në procesverbalin e kqyrjes së vendit të ngjarjes të datës 18.03.2002.

Duke analizuar procesverbalin për kqyrjen e vendit të ngjarjes të datës 18.03.2002 të mbajtur nga grupi hetimor, nuk evidentohet në asnjë rresht të tij fiksimi i kesaj gjurme.

Kjo gjurmë rezulton vetëm pas katër viteve të ngjarjes datë 26.07.1998 në aktin e ekspertimit vlerësues i provës materiale Nr.641 datë 19.03.2002 dhe aktin e ekspertim daktiloskopik Nr.644 datë 19.03.2002.

Edhe dëshmitarët nuk e implikojnë të pandehurin Ilir Xhakja me ngjarjen e datës 26.07.1998 (një pjesë prej të cilëve iu lexuan thëniet ne zbatim te nenit 369 të K.Pr.Penale dhe disa prej tyre deklaruan në gjykim), madje as njerëz të afërm të viktimës.

Kështu nipi viktimës shtetasi Agron Maloku, në deklarinimet e dhëna para OPGJ-së më datë 26.07.1998 shprehet se është takuar me viktimën rreth ores 23:00 te dates 26.07.1998 në lokalin e tij dhe më pas viktimë ishte nisur për tek bilardo. Pas disa çastesh ka degjuar krisma armesh dhe pak me vone ka pare dy persona te armatosur qe shkonin drejt tij dhe pasi i janë afruar per rreth 20 m, kane shtire ne ajer mbi kokat e personave qe dolen ga lokali.

Deklaruesi, nipi viktimës, që është dëshmitar kryesor i vendit ngjarjes, në asnjë moment nuk e ka implikuar të pandehurin Ilir Xhakja në vendin e ngjarjes që do të thotë se e përjashton si autor të mundshëm. Dëshmitari i ka pare personat nga 20 m larg dhe nuk i ka njohur që llogjikisht po te

ishin nga fshati i tij do ti kishte njohur pasi personat nuk kane qenë te maskuar.

I pandehuri Ilir Xhakja është nga Sukthi dhe fqinj me deklaruesin dhe nese do te kishte qene ky i fundit nje nga personat autor qe shtine mbi te ndjerin, do të identifikohet nga nipi viktimës.

Edhe dëshmitarja Besnike Maloku bashkëshortja e nipit të viktimës nuk e implikon të pandehurin Ilir Xhakaj me ngjarjen e datës 26.07.1998. Ajo deklaroi në gjykim se ditën e ngjarjes apo edhe pas saj nuk e kishte parë të pandehurin të armatosur.

Po kështu dëshmitari Maksut Zhiti me detyrën punonjës i policisë kriminale i zonës që ka kryer veprimet e para procedurale në vendin e ngjarjes deklaroi në gjykim se i pandehuri Ilir Xhakja nuk ka qenë në momentin e vrasjes se shtetasit Qerim Maloku në Katund Sukth dhe se në cilesine e inspektorit te zones është interesuar per vendndodhjen e tij dhe pasi ka folur ne telefon me kete te fundit ka vertetuar qenien e tij në Gjermani. Po kështu në dëshmi ky dëshmitar konfirmoj faktin se pjestarë të familjes Xhakja merrnin pjesë në mortin e familjes Maloku.

Një provë shumë e rëndësishme dhe e pakontestuar nga organi akuzës është vërtëtimi banimit lëshuar nga zyra e regjistrimit të popullsise të qytetit të Memmingen të Gjermanisë, vërtëtim i cili mban dhe vulën e Ambasadës Shqiptare në Berlin me Nr.regjistri 330 datë 13.03.2003.

Ky vërtëtim vërtëton faktin se i pandehuri Ilir Xhakja ka qenë në qytetin Memmingen nga data 14.02.1998 deri ne 14.08.1998.

Po kështu faktin e qenies të të pandehurit Ilir Xhakja në Gjermani e konfirmuan dhe dëshmitarët Fatbardh e Arben Xhakja.

Edhe dëshmitarët e tjerë, Selami Sheta, Florian Metalla, Shkëlqim Sheta e Gëzim Laska nuk e implikojnë të pandehurin Ilir Xhakja në ngjarjen e datës 26.07.1998.

Për sa më sipër si dhe duke u nisur nga parimi prezumimit të pafajsisë, neni 4 i K.Pr.Penal në të cilin shprehimisht thuhet se ; *“Cdo dyshim për akuzën çmohet në favor të pandehurit.”* si dhe parimit që provat i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor e nuk kanë vlerë të paracaktuar, gjykata krijon bindjen se në rastin konkret nuk provohet që i pandehuri Ilir Xhakja të ketë kryer veprën penale të vrasjes së shtetasit Qerim Maloku de për rrjedhojë edhe bashkëpunimi.

Sa i përket akuzës së mbajtjes pa leje të armëve luftarake e municioneve të parashikuar nga neni 278/II i K.Penal, organi akuzës kërkoi pushimin e çështjes dhe edhe gjykata bazuar në nenin 387/I të K.Pr.Penale çmon se kjo akuzë duhet pushuar.

Për këto arsye

Gjykata bazuar në nenet 388/1/d e 387/I të K.Pr.Penale

VENDOSI

Të deklaroj të pafajshëm të pandehurin Ilir Azem Xhakja për veprën penale të vrasjes me paramendim të shtetasit Qerim Maloku, të kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 78 paragrafi I e 25 të K.Penal, pasi nuk provohet që i pandehuri ta ketë kryer veprën penale që akuzohet.

Pushimin e çështjes penale penale sa i përket akuzës së mbajtjes pa leje te armëve e municioneve luftarake parashikuar nga neni 278/II i K.Penal bazuar kjo në nenin 387/I të K.Pr.Penale.

Shpenzimet procedurale penale siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij në Gjykatën e Apelit Durrës.

U shpall në Durrës më datë 09.02.2011

SHPENZIMET GJYQËSORE	
Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

ANËTAR

Fejzo Hysi

ANËTAR

Ndue Gjura

KRYESUES

Neritan Tabaku